



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2276 prot.

Pogradec, më 20, 05, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

"DHËNIEN E BONUSIT TË QERASË PËR ZNJ. MANJOLA ZABZUNI NË BASHKINË POGRADEC"

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më __, __, 2024

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2024

**“PËR DHËNIEN E BONUSIT TË QERASË PËR ZNJ. MANJOLA ZABZUNI,
NË BASHKINË POGRADEC”**

Në mbështetje të Nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe Ligjit Nr. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL “ përkatësisht :Neni 3, pika 3 ; Neni 33, pika 1 “PËR SUBVENCIONIMIN E QERASË”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. T’i japë Znj.Manjola Zabzuni, me probleme social-ekonomike në nevojë, Bonus Qeraje sipas programit të Strehimit Social.

Emër	Mbiemër	Gjendja Sociale	Njësia Administrative	Vlera e Kontratës së Qerasë	Afati i Kontratës	Totali
Manjola	Zabzuni	E ve, Familje me 3(tre) fëmijë.	Pogradec	12,000 Lekë	12 Muaj	144,000 Lekë

2. Kjo shumë prej 144,000 (Njëqind e dyzetë e katër) lekë, do të mbulohet nga Fondi Rezervë në Bashkinë Pogradec.
3. Pagesa kryhet në bazë të paraqitjes së kontratave të qerasë për secilin aplikues në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit, si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT,
ADMINISTRIMI I TOKËS BUJQËSORE NË NJ. A., TRANSPORTIT DHE SHERBIMEVE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

RELACION

“PËR DHËNIEN E BONUSIT TË QERASË PËR ZNJ. MANJOLA ZABZUNI,
NË BASHKINË POGRADEC”

Në vijim të kërkesës së znj. **Manjola Osman Zabzuni**, u përgatit dokumentacioni i duhur për të përfituar nga Programi Social i Strehimit “*Subvencionim i Qerasë*” për familjen Zabzuni, pasi u evidentua gjendja sociale dhe ekonomike e saj.

Aplikuesja është nënë e vetme me 3 fëmijë, në bazë të kushteve të vështira ekonomike dhe papunësisë kemi parë të arsyeshme të japim Subvencionim Qeraje për 12 muaj në vazhdim , sipas tabelës Nr.1 .

Dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi:

1. Kërkesë online e znj. **Manjola Osman Zabzuni** drejtuar Bashkisë Pogradec.
2. Çertifikatë familjare
3. Çertifikate personale.
4. Vërtetim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.
5. Vërtetim që nuk ushtron aktivitet privat.
6. Vërtetim nga ASHK mbi pasuritë e paluajtshme.

Konceptoi : K. Liçkollari & E.Balliu

Konfirmoi: M. Ziko

Miratoi : B. Niko

Konfirmoi:

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI